

VENDIM
Nr.577, datë 23.8.2006

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS GURI I ZI, TË QARKUT TË SHKODRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore (lidhja 1), që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Guri i Zi, të qarkut të Shkodrës, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Guri i Zi, të qarkut të Shkodrës, miratuar me vendimin nr.472, datë 16.7.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Guri i Zi”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Guri i Zi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Gur i Zi
Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
10-11	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
12-14	Prona që përdoren në fushën kulturore dhe sportive	Në pronësi
15-25	Varrezat publike	Në pronësi
26-35;192-221;256-265	Infrastrukturë dhe shërbim publik	Në pronësi
36-191	Pyje dhe kullota	Në pronësi
226;227;228;230	Mbrojtje kombëtare	Në pronësi
232-254	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit	Në përdorim
255;270;276;284;288;293;300;309;311;315;319;321;324	Toka bujqësore inproduktive, kanale të treta	Në pronësi